



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 53/6 Prot.

Tiranë, më 28/2/2014

U R D H E R

Nr 07, datë 28/02/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "LOTTO SPORT" sh.a, Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 13 datë 22.01.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "LOTTO SPORT" sh.a, Tiranë me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetasit N.S drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me: "1) përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet dërgimit të e-maileve me qëllim marketingu (reklama dhe mesazhe promovionale), pa pëlqimin paraprak të marrësit të e-mailit, shtetasit N.S (palës ankuese), 2) detyrimin për informimin e marrësit të e-mailit (shtetasit N.S) në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar";
- Verifikimi i procedurave të realizimit të mesazheve promovionale, të kryera nga kontrolluesi drejt subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale;
- Verifikimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale në përputhje me Udhëzimin nr. 16 datë 26.12.2011 për "Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë", i ndryshuar;
- Verifikimi i procedurave për marrjen e pëlqimit mbi dërgimin e mesazheve promovionale, të kryera nga kontrolluesi drejt subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale;
- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21 i ligjit).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, si dhe provat e administruara vëren se:

Inspektimi administrativ ka filluar duke u nisur nga ankesa shtetasit N.S pranë zyrës së Komisionerit. Ankuesi pretendon se në adresën personale të e-mail, i ka ardhur një e-mail me qëllim marketingu (*reklama dhe mesazhe promociionale*), dërguar nga luajmene@lotosport.com.al, pa pëlqimin paraprak të tij. Ankuesi thekson se nuk ja ka dhënë adresën e tij të e-mail kësaj kompanie, nuk është regjistruar pranë saj dhe nuk i jepet mundësia që të çregjistrohet nga sistemi që kjo kompani ka në dispozicion, në mënyrë që të mos jetë subjekt i reklamave apo mesazheve promociionale. Ankuesi nuk është ankuar paraprakisht tek kontrolluesi por i është drejtuar menjëherë Autoritetit të Komisionerit.

"LOTTO SPORT" sh.a në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, është kontrollues privat, i cili ushtron aktivitetin e tij në fushën e lojërave të fatit dhe parashikimeve sportive të çdo lloji. Gjatë këtij aktiviteti mbledh të dhëna personale të klientëve, që regjistrohen me pëlqimin e tyre me qëllimin për të luajtur online. Të dhënat personale që përpunohen janë: emër, mbiemër, datëlindje, numër telefoni, e-mail, adresa e banimit etj.

1. Kontrolluesi nuk realizon marrjen e pëlqimit specifik të klientëve për marrjen e mesazheve promociionale, duke shkelur nenin 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar sipas të cilit...*"1. Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin"*.

Respektimi i këtij neni do të bëjë të mundur që ju si kontrollues të regjistroni subjektet e të dhënave personale drejt të cilëve dërgoni komunikime tregtare të pakërkua në varësi të pëlqimit që ato kanë dhënë, kjo edhe në zbatim të nenit 9/3 të ligjit nr.10128, datë 11.5.2009 *"Për tregtinë elektronike"*.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se kontrolluesit dhe përpunuesit mund të përpunojnë të dhënat personale me mjete automatike ose me mjete të tjera, vetëm duke zbatuar parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar. Zbatimi i kërkesave të këtij neni është bërë imediat edhe në përpunimin e të dhënave personale nga kontrollues dhe përpunues në sektorë të ri e të rëndësishëm që janë prezent në vendin tonë, siç është dhe marketingu. Pëlqimi si rregull duhet të jetë i shprehur në formë të shkruar dhe specifik për pranimin e e-mail me qëllim marketingu. Në një shoqëri moderne të konsumit shërbimet e marketingut direkt janë në rritje të vazhdueshme, prandaj është e rëndësishme që kontrolluesit e të dhënave personale t'i përdorin ato vetëm në përputhje me të drejtat themelore të njeriut. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikon se: *"Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me veten e tij apo të saj. Të dhëna të tilla duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të drejtë për qëllimet e specifikuar dhe në bazë të pëlqimit të personit të interesuar, ose në bazë legjitime të përcaktuara me ligj. Gjithkush ka të drejtën e aksesit ndaj të dhënave të cilat janë mbledhur në lidhje me të dhe të drejtën për të korrigjuar të dhënat"*.

2. Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që ai ka marrë për të dhënat personale të tyre. Kontrolluesi nuk ka informuar subjektet e të dhënave lidhur me përhapjen e të dhënave personale drejt përpunuesit *"New Media Communications"* dhe qëllimin e përhapjes që konsiston në kryerjen e marketingut. Në faqen në internet të kontrolluesit, nuk është e publikuar rubrika *"politikat e privatësisë"*. Në këtë rast është shkelur neni 18/1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i

ndryshuar dhe kreu I-rë (pika 2 dhe pika 3.2) i Udhëzimit nr. 16 datë 26.12.2011 për "Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit, i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mbledhen nga individët e interesuar (klientët) informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqes tuaj të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

3. Në kontratën e lidhur midis kontrolluesit "**LOTTO SPORT**" sh.a dhe përpunuesit "**New Media Communications**", nuk është parashikuar pala përgjegjëse për marrjen e pëlqimit të klientëve me qëllim dërgimin e e-mail për fushatë publicitare dhe promocion. Përpunuesi ka përhapur të dhënat te palë të treta (persona fizik) me qëllim kryerjen e marketingut. Në këtë rast është shkëlur neni 20/1/2 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i një kontratë ku të merret përsipër garantimi për përdorimin e ligjshëm dhe të siguritë të të dhënave është detyrë parësore e kontrolluesit. Ligjshmëria dhe siguria për përdorimin e të dhënave personale nga përpunuesi të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve të Komisionerit duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgimin dhe kontrollin nga ana e kontrolluesit. Kujtojmë se edhe përpunuesi ka detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, detyrim ky i parashikuar në nenin 28 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, duke shkëlur në këtë rast: nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe kreun VIII të Udhëzimit 16 datë 26.12. 2011 për "Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

URDHEROJ

1. Në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar:
 - Të fshihen menjëherë të dhënat personale të ankuesit N.S nga sistemi juaj i mbajtjes të të dhënave dhe në adresë të ankuesit të mos dërgohen më mesazhe promovionale pa marrjen e pëlqimit specifik të tij, për të pranuar mesazhe promovionale.
 - Të merret pëlqimi specifik i klientëve për të pranuar në adresat e tyre të e-mail mesazhe promovionale.
 - Mesazhet promovionale të dërgohen vetëm në adresë të subjekteve që kanë dhënë pëlqimin e qartë dhe të shprehur për marrjen e mesazheve promovionale.
 - Për çdo subjekt të të dhënave, i cili dëshiron të regjistrohet në sistemin online, të ofrohet mundësia e refuzimit të marrjes së e-mail me qëllim marketingu.
 - Të merret pëlqimi për të gjithë klientët, të cilët nuk kanë patur mundësi teknike për të dhënë pëlqimin, pasi janë regjistruar para ofrimit të shërbimit të konfirmimit të pëlqimit.
 - të kontrollohet rregullisht dhe të respektohet regjistri e përjashtimeve, për subjektet e të dhënave personale të cilëve ju jeni drejtuar, por që nuk kanë dëshirë të marrin komunikime të tilla tregtare.
2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,
 - të bëhet informimi i subjekteve të të dhënave personale (klientët, përdoruesit ose vizitorët e sistemit online) mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, të drejtën për akses, të drejtën për korigjim, përhapjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre.
 - në faqen tuaj në internet luajmene@lottosport.com.al të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t’i gjeni në Opinionin “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat” publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.
3. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, në kontratën e lidhur midis kontrolluesit “**LOTTO SPORT**” sh.a dhe përpunuesit “**New Media Communications**”, të parashikohet:
 - Pala përgjegjëse për marrjen e pëlqimit specifik të klientëve me qëllim dërgimin e e-mail për fushatë publicitare dhe promovion.

- Subjektet ku përhapen të dhënat personale të klientëve, duke parashikuar procedurat përkatëse.
 - Në zbatim të kreut VII të udhëzimit nr. 16 datë 26.12. 2011 për “*Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë*” i ndryshuar, të parashikohen masat e sigurisë për përpunimin e të dhënave personale.
4. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.
 5. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Urdhëri.
 6. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 7. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, sipas të cilit... “*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*”.
 8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)